

Vendim nr. 71 datë 05.04.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 05.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (P) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PETRIT ALIAJ**

OBJEKTI: **Anulimi i vendimeve të kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 99, datë 16.11.2020, nr. 30, datë 12.03.2021, nr. 82, datë 01.06.2021, nr. 134, datë 01.12.2021, nr. 79, datë 06.07.2022 dhe nr. 120, datë 28.09.2022, si të pavlefshme, për shkak të afatit kushtetues ligjor të bërjes ankim në Gjykatën Kushtetuese, ankim i bërë konform ligjit në datën 21.09.2020 dhe jo në datën 22.03.2021.**

Shfuqizimi i vendimeve nr. 198, datë 01.02.2013 dhe nr. 9, datë 27.05.2020 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për shkaqet e parashtruara në ankimin e datës 21.09.2020.

Lënia në fuqi e vendimit nr. 6260, datë 13.07.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142, pika 1, 145, pika 1 dhe 178, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjo i relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë oficer aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Me urdhrin nr. 2660/1, datë 10.11.1993 të ministrit të Mbrojtjes është nxjerrë në rezervë dhe për periudhën nga 11.11.1993 deri më 31.12.1995 është trajtuar me pagesë kalimtare.

2. Me kërkesën e tij, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë, me vendimin nr. 486, datë 17.06.2000 “Për caktim pensioni”, i ka njohur kërkuesit të drejtën për të përfituar pensionin e parakohshëm në shumën 8.000 lekë, duke filluar nga data 01.01.1999.

3. Me vendimin e datës 28.02.2008 “Për caktimin e pensionit të pleqërisë” të *DRSSH*-së, Tiranë ka filluar trajtimin me pension pleqërie për kërkuesin nga data 01.03.2008.

4. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar nga *DRSSH*-ja rilidhjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pagimin e diferencës së masës së pensionit nga zbatimi i gabuar i ligjit, vazhdimin e trajtimit me pension të parakohshëm dhe rillogaritjen e masës së pensionit për çdo vit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6260, datë 13.07.2009, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe detyrimin e *DRSSH*-së, Tiranë që të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndaj paditësit dhe t’i paguajë diferencën e papaguar të këtij pensioni.

6. Mbi ankimin e *DRSSH*-së, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1441, datë 14.07.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 6260, datë 13.07.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe detyrimin e *DRSSH*-së, Tiranë t’i paguajë kërkuesit diferencën e papaguar të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, detyrim që i përket periudhës nga 03.06.2005 deri në momentin e daljes së paditësit në pension pleqërie. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesi dhe *DRSSH*-ja, Tiranë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

8. Në datën 10.07.2013 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të po asaj gjykate. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-9, datë 27.05.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se shkaqet e parashtuara nuk bazohen në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9. Me kërkesën e datës 21.09.2020 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 16.11.2020, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione temporis*, pasi kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

10. Në vijim, me kërkesën e datës 18.01.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, kurse me kërkesën e datës 22.03.2021 ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për rillogaritjen e pensionit të tij. Edhe në lidhje me këto kërkesa, me vendimet nr. 30, datë 12.02.2021 dhe nr. 82, datë 01.06.2021 të kolegjeve të Gjykatës është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

11. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën e datës 22.07.2021 për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, si dhe pavlefshmërinë e vendimeve të sipërcituara të kolegjeve të kësaj Gjykate. Në lidhje me këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 134, datë 01.12.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke arritur në përfundimin se për pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor para gjykatave të zakonshme, kërkuesi nuk legjitimohej *ratione temporis*. Për sa u përket pretendimeve për vendimmarrjet e kolegjeve të kësaj Gjykate, ajo është shprehur se këto vendime nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë asaj. Mbledhja e Gjyqtarëve ka vërejtur, gjithashtu, se edhe pse kërkuesi ka marrë përgjigje se nuk ka respektuar afatin ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ai ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura, për të njëjtat shkaqe dhe objekt. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve i ka sjellë në vëmendje kërkuesit përmbajtjen e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, që parashikon gjobitjen në rast të paraqitjes së kërkesës abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, por duke qenë se kërkuesi nuk është paralajmëruar më parë me

vendim të kolegjeve për mundësinë e gjobitjes së tij, nuk e ka çmuar të arsyeshme zbatimin e kësaj dispozite (*shih paragrafët 30-33 të vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

12. Pas paraqitjes së katër kërkesave rresht, siç u sqarua më sipër, me kërkesën e datës 05.04.2022, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar për herë të pestë Gjykatës, duke pretenduar moszbatimin e kritereve në shqyrtimin paraprak të kërkesës së tij, në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, si dhe shkelje të rënda në procesin e zhvilluar në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë.

13. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 79, datë 06.07.2022, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pasi kërkuesi ka përsëritur po të njëjtat pretendime dhe nuk ka parashtruar asnjë shkak të ri për të mbështetur pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme.

14. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Kolegjit, në datën 29.07.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke parashtruar se ka paraqitur një shkak të ri në mbështetje të pretendimeve të tij, por Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 120, datë 28.09.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim, duke argumentuar se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi nuk janë të reja dhe ato kanë qenë objekt vlerësimi nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës gjatë shqyrtimit të kërkesave të mëparshme të paraqitura nga kërkuesi. Po ashtu, Kolegji i ka tërhequr sërish vëmendjen kërkuetit për faktin se ai, pavarësisht se është paralajmëruar disa herë, ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura dhe abuzive, me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat shkaqe, çka përbën bazë të mjaftueshme për zbatimin e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, që parashikon gjobitjen në shumën nga 100.000 deri në 500.000 lekë (*shih paragrafin 23 të vendimit nr. 120, datë 28.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës*).

15. Pavarësisht sa më sipër, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesën e datës 19.01.2023, duke pretenduar anulimin e vendimeve të mësipërme të Gjykatës Kushtetuese.

16. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuetit

17. **Kërkuesi** ka pretenduar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- 17.1. *Cenimin e së drejtës për t`u njoftuar* për seancat dhe vendimet gjyqësore. Sipas nenit 171/a të KPC-së, gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj. Vendimet e shpallura jashtë seancës, ndaj të cilave lejohet ankim, u komunikohen palëve jo më vonë se tri ditë nga shpallja e tyre. Gjykata e Lartë nuk i ka zbatuar këto parashikime në marrjen e vendimit nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013, çka provohet nga përgjigja e kërkesës nr. 911/3 prot., datë 28.07.2022.
- 17.2. Sipas nenit 444 të KPC-së afatet e përcaktuara në nenin 443 të tij fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Kërkuesi nuk është njoftuar për muajin, ditën, orën dhe trupin gjykues nga Gjykata e Lartë dhe për këtë arsye kërkesën për rishikim e ka paraqitur pas më shumë se 5 muajsh. Vendimi nr. 00-2020-9, datë 27.05.2020 i Kolegjit Administrativ nuk i është njoftuar nëpërmjet nëpunësit gjyqësor që ai të humbiste të drejtën për t`iu drejtuar Gjykatës, duke humbur kështu të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Gjykata e Lartë kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013 e ka shqyrtuar pas 7 vjetësh.
- 17.3. Vendimet e kolegjeve të Gjykatës janë të pasakta dhe të paqarta e në to bëhen referime në vendime të tjera të Gjykatës, që nuk kanë lidhje me çështjen e kërkuesit. Kolegji nuk ka arsyetuar shkaqet e reja të paraqitura prej tij në datën 29.07.2022.
- 17.4. Kolegjet kanë mbajtur qëndrime të njëanshme, paragjyqëse dhe të ndryshme për të njëjtin objekt. Nuk është mbajtur i njëjti standard me vendimet nr. 19, datë 21.01.2014, nr. 81, datë 18.12.2017 dhe nr. 3, datë 06.02.2018 që kanë të njëjtin objekt dhe bazë ligjore me vendimin nr. 99, datë 16.11.2020.
- 17.5. Procesi përpara Gjykatës është zgjatur tej afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me ligjin nr. 8577/2000. Kërkuesi ka qenë në pamundësi të plotësimit të mangësive për shkak të moskthimit përgjigje nga Gjykata e Lartë brenda 10 ditëve.
- 17.6. Kolegjet nëpërmjet frikësimit me nenin 31/c të ligjit nr. 8577/2000 pretendojnë tërheqjen e kërkuesit dhe mbylljen e procesit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

18. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, fillimisht, se kërkuari ka paraqitur në mënyrë të përsëritur 7 herë kërkesa në Gjykatë (në datat 21.09.2020, 18.01.2021, 22.03.2021, 22.07.2021, 05.04.2022, 29.07.2022 dhe 19.01.2023), duke kundërshtuar të njëjtat vendime gjyqësore të gjykatave të zakonshme që kundërshton edhe në kërkesën në shqyrtim dhe, në thelb, edhe për të njëjtat shkaqe.

19. Në kërkesën e paraqitur në datën 29.07.2022, në zbatim të vendimit nr. 79, datë 06.07.2022 të Kolegjit të Gjykatës, që e ka kthyer atë për plotësim, kërkuari ka pretenduar se ka parashtruar një shkak të ri për kundërshtimin e procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Sipas tij, nuk janë respektuar dispozitat procedurale civile dhe ato të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, që kanë të bëjnë me njoftimin e vendimit nga nëpunësi gjyqësor, si dhe njoftimin e datës dhe orës së shqyrtimit të rekursit, lidhur kjo me momentin e marrjes dijeni të vendimit dhe fillimin e afatit të ankimit. Për këtë shkak ai ka paraqitur me vonesë kërkesën për rishikim, ndërsa vendimi i Kolegjit Administrativ nuk i është njoftuar nëpërmjet nëpunësit gjyqësor që ai të humbiste të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke humbur kështu të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

20. Kolegji, me vendimin nr. 120, datë 28.09.2022, referuar shkaqeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, ka vlerësuar se këto pretendime nuk janë të reja, pasi kanë qenë objekt vlerësimi nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës gjatë shqyrtimit të kërkesave të mëparshme të paraqitura nga kërkuari (*shih paragrafin 18 të vendimit nr. 120, datë 28.09.2022 të Kolegjit*).

21. Më konkretisht, me vendimin nr. 99, datë 16.11.2020 të Kolegjit të Gjykatës është vlerësuar se në lidhje me vendimin nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kërkesa është paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor. Kurse në lidhje me pretendimin e kërkuarit se afati 4-mujor fillon nga data 27.05.2020, kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij për rishikimin e vendimit, Kolegji ka vlerësuar se paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga

gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Për më tepër, ashtu siç individëve iu kërkohet që për efekte të shterimit të mjeteve juridike të përdorin vetëm mjetet normale të ankimit, duke mos i detyruar të përdorin mjete të jashtëzakonshme ankimi (sikurse është edhe kërkesa për rishikim), në të njëjtën linjë, individët nuk mund të pretendojnë përmbushjen e afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimeve kushtetuese duke u bazuar në përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, të cilat janë refuzuar nga gjykata si haptazi të pabazuara në ligj (*shih paragrafët 18-21 të vendimit të Kolegjit*).

22. I njëjti qëndrim, në lidhje me momentin e fillimit të afatit të ankimit kushtetues, është mbajtur edhe në vendimin nr. 82, datë 01.06.2021 të Kolegjit të Gjykatës, ku është vlerësuar se pretendimet e reja të kërkuarit ndaj procesit gjyqësor të themelit, të përfunduar me vendimin gjyqësor të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rillogaritjen e pensionit të ushtarakut, janë paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë ato nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues në seancë plenare (*shih paragrafët 14-15 të vendimit të Kolegjit*).

23. Kolegji, me vendimin nr. 120, datë 28.09.2022, ka vlerësuar se pavarësisht pretendimeve të paraqitura në kërkesën në shqyrtim për mungesën e njoftimit të vendimit nga nëpunësi gjyqësor, minimalisht kërkuar ka marrë dijeni për vendimin nr. 00-2013-198, datë 01.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në ditën e paraqitjes së kërkesës për rishikim, që referuar vendimit nr. 00-2020-9, datë 27.05.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe akteve të paraqitura bashkëlidhur kërkesës, është data 10.07.2013. Në kërkesën për rishikim kërkuar ka kërkuar pikërisht rishikimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual, duke ngritur pretendime për njoftimin e tij, si dhe për zbatimin e ligjit material. Për rrjedhojë, që prej këtij momenti, kërkuar nuk kishte asnjë pengesë të paraqiste kërkesë drejtpërdrejt në Gjykatë për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë shqyrtuar çështjen e rillogaritjes së masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke provuar edhe momentin e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e Kolegjit Civil, në kushtet kur paraqitja e kërkesës për rishikim nuk është një mjet i zakonshëm ankimi që kërkohet të shterohet përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

24. Në këtë mënyrë, kërkuar ka humbur përfundimisht të drejtën për të paraqitur ankim kushtetues individual në lidhje me parregullsitë e pretenduara në procesin gjyqësor objekt

kërkese dhe asnjë lloj pretendimi, pavarësisht natyrës së tij, nuk mund ta rivendosë në afatin e ankimit për kundërshtimin e vendimeve që janë shprehur për të drejtën dhe masën e pensionit të parakohshëm, si dhe për kërkesën për rishikim, për të cilat, në vendimet e sipërcituara të Kolegjeve dhe Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës, në mënyrë të përsëritur dhe përfundimtare është arsyetuar se kërkuuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

25. Për sa u përket pretendimeve të kërkuessit për vendimmarrjet e kolegjeve të kësaj Gjykate, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ato nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë asaj, pasi në kuptim të neneve 124, 132 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës vendimet e Gjykatës kanë forcë detyruese dhe natyrë përfundimtare. Në kuptim të dispozitave kushtetuese, në nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 është parashikuar, gjithashtu, se vendimet e kësaj Gjykate kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

26. Mbledhja e Gjyqtarëve, gjithashtu, vëren se në kërkesën objekt shqyrtimi, kërkuuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm para Gjykatës. Bazuar në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, kushdo që është palë në procesin që zhvillohet para Gjykatës dhe pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të pretendojë shpërblim të drejtë nga Gjykata, nëse konstatohet se nga kjo tejzgjatje i janë cenuar të drejtat dhe liritë.

27. Në vijim të sa u parashtrua më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se edhe në kërkesën konkrete kërkuuesi ka përsëritur po të njëjtat argumente, si për llogaritjen e afatit 4-mujor, ashtu edhe për pretendimet e tjera, për të cilat ka marrë përgjigje shteruese nga kjo Gjykatë, gjë që e bën kërkimin e tij të konsiderohet i kryer me natyrë abuzive. Në kushtet kur kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës për pretendime të cilat janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar disa herë në mënyrë përfundimtare, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi dhe të vihen më në diskutim nga kjo Gjykatë.

28. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se në rastin konkret kërkuuesi gjendet në kushtet e abuzimit me të drejtën për të paraqitur kërkesë, pasi pavarësisht se ai është paralajmëruar disa herë dhe i është tërhequr vëmendja për vendosjen e gjobës, ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura dhe abuzive, me të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata, çka përbën bazë të mjaftueshme për zbatimin e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 20, pika 2, shkronja "b", të Rregullores për Procedurat

Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilave: (i) kur kërkuesi paraqet kërkesë të përsëritur, (ii) për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo (iii) është shqyrtuar një herë nga Gjykata, ajo (iv) urdhëron gjobitjen e kërkuesit ose përfaqësuesit ligjor me gjobë në shumën nga 100.000–500.000 lekë¹. Kërkuesi i ka konsumuar të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 31/c i ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 20, pika 2, shkronja “b”, i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë Mbledhja e Gjyqtarëve do të vijojë edhe me zbatimin e pasojës së parashikuar ligjore për këto raste.

29. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve, duke marrë parasysh se kërkuesi gjendet në kushtet e abuzimit me të drejtën për të paraqitur kërkesë, urdhëron gjobitjen e tij me vlerën minimale të parashikuar nga ligji për t’i shërbyer në ndërgjegjësimin e ushtrimit të të drejtave në mënyrë efektive.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 20 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

V E N D O S I:

1. Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
2. Caktimin e gjobës në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj kërkuesit Petrit Aliaj.
3. Ngarkohet Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit.

¹ Votuan kundër për gjobën gjyqtarët Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska.